





FATOS KONGOLI  
**GËNJESHTARË TË VEGJËL**

ROMAN

---

BOTIMET TOENA

*Çdo ngjashmëri me persona, mjedise dhe ngjarje reale  
është e rastit. Gjithçka në këtë libër është prodhim i fantazisë.*

AUTORI

**FATOS KONGOLI**

GËNJESHTARË  
TË VEGJËL

roman

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-35-0

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: [redaksia@toena.com.al](mailto:redaksia@toena.com.al)

[botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

# 1.

*Gusht - 2015*

**A**jo e mori në telefon në mes të natës. Prej gjashtë muajsh shiheshin vetëm kalimthi, me raste, nuk komunikonin dhe emri i saj ishte i fundit që priste t'i shfaqej në ekranin e celularit. Ai mbeti në mëdyshje, t'i përgjigjej apo jo; kapitullin me Emën e quante të mbyllur. Kapitulli me Emën ishte mbyllur dhe rihapur më se një herë, por gjashtë muaj të shkuar ai qe bindur përfundimisht: midis tyre nuk funksiononte. Ajo ishte e bukur, e lirshme, ndërsa ai xheloz. Kështu e akuzonte vajza. Dhe grindeshin.

Pasi grindeshin, atij i ndodhte të vuante deri në atë masë sa, për të shpëtuar, ishte gati t'ia këpuste vetes. Ose të vriste Emën.

Doemos, nuk bënte as njërrën, as tjetrrën. Përkundrazi, ajo zotëronte një aftësi të rrallë për të vendosur paqe midis tyre, kështu ai çlirohej nga idetë ogurzeza dhe gjithçka rifillonte si të mos kishte ndodhur asgjë.

Këtë mendoi edhe atë mesnatë gushti, kur në ekranin e celularit iu shfaq emri i saj; po t'i përgjigjej, rrezik të binte pre e dobësisë së tij. Kjo do të thoshte të riniste historia e vjetër. Ai s'kishte kurrfarë dëshire për të rinisur historinë e vjetër.

Gjashtë muaj të shkuar, pas përplasjes me Emën - thjesht një pretekst ky - kishte vendosur të ndërmerre disa veprime, që i bluante prej kohësh e që do të mund të quheshin radikale. Mbi të gjitha, të shkëpuste më në fund çdo marrëdhënie me kompaninë "Luga", ku ishte i punësuar në zyrën e financave plot pesë vjet të shkuara. Mirëpo, tashmë i kishte ardhur në majë të hundës, nuk duronte dot më. Disa fytyra, duke nisur nga ajo e bosit, ia shpifnin. Kështu, i ngarkuar për gjashtë muaj radhazi me idenë e vjetër të një rebelimi, në kushtet e përballjes së përditshme me poshtërimin e vetes, ai mundi të hiqte dorë vetëm nga Ema, asgjë më shumë.

"Çfarë dreqin kërkon ajo prej meje tani, - mendoi, - ç'hall mund të ketë që më telefonon në mes të natës?"



**N**ë krye, e shoh me vend të të them se kush jam. Ti - ndjesë që po të drejtohem me “ti” dhe jo me “ju”, siç e duan rregullat e edukatës, formalisht ne s’njihemi - nuk je e detyruar të bësh të njëjtën gjë, të më thuash kush je, çfarë je, ç’moshë ke, me se merresh. Unë i di këto, e di kush je, e kam ditur gjithmonë: ti je ajo pas së cilës kam rendur gjithë jetën, pa mundur ta gjej.

Po shpjgohem! Vendimin për të komunikuar me ty e kam marrë pas një reflektimi të gjatë, i pasigurt nëse duhej ta bëja këtë, i pasigurt sidomos nëse ti ke apo nuk ke dëshirë të më dëgjosh. Edhe nëse ti s’më dëgjon, s’ke dëshirë

të më dëgjosh dhe ndoshta nuk je fare si të përfytyroj, një qenie me bonsens, po të huazoj një shprehje të të ndjerit Orest Diamanti, unë prapë nuk heq dorë. Dua ta çoj deri në fund këtë orvatje për të shtjelluar ca të vërteta të miat. S'e kam fjalën thjesht për dashurinë e nënshtruar ndaj Emës. As për rolin që luajti ajo në rëndimin gradual të krizës sime. Është më shumë një detyrim moral, post mortem, ndaj mikut tim të larguar për në botën tjetër këtu e dy vjet të shkuara, aq sa më është dashur edhe mua të mbledh veten.

Kush është ky Orest Diamanti, do të pyesësh ti! Më saktë, kush ishte? Shkurt, fare shkurt, do të thosha:

Në çastin kur u largua nga kjo botë dy vjet të shkuara, ai ishte një burrë rreth të shtatëdhjetave. I ndjeri s'do të ma falte sikur të më dëgjonte ta cilësoja “një plak” rreth të shtatëdhjetave. Dhe ka të ngjarë të zemërohej keq me mua nëse, duke dashur të shpreh nderimin ndaj tij, të shtoja epitetin e rëndomtë “person i njohur publik”.

Tani, unë e teproj ca duke e cilësuar “miku im”, nuk e di se çfarë do të thoshte po të më dëgjonte ta quaja kështu. Pavarësisht se çfarë do të thoshte, unë s'mund ta quaj ndryshe,

përveçse kështu, pra miku im. Por, hëpërhë, ta lëmë Orestin atje ku është. Në Parajsë besoj. Ndoshta edhe në Ferr, nuk e vë dorën në zjarr.

Jam me origjinë nga fshati. E ke dëgjuar ndonjëherë atë shprehjen që përcillet brez pas brezi: “Katundar o vesh parur, dhe po ndërrove shtatë lëkurë, qytetar nuk bëhesh kurrë”? Mos më thuaj “jo” për të mos më mërzhitur. Unë nuk mërzhitem. Thjesht më vjen të shkrihem gazit! Njëherazi, t’ia jap ulërimës!

Të shkrihem gazit, sepse kjo shprehje më zbavit, nuk e kam në dorë të mos qesh. Njëherazi më vjen të ulërij. Në rininë e hershme vuaja nga një kompleks inferioriteti, që më induktonte ky cinizëm shqiptaro-shqiptar, nëse më lejon ta quaj kështu, ndonëse i përkisja një familjeje të kategorisë së të ashtuquajturve intelektualë të fshatit: im atë, sot pensionist, ishte me profesion mësues. Në shkollë vinte gjithmonë me kostum e kravatë, vishej dukshëm më mirë se disa arsimtarë të ardhur nga qyteti, të cilët atëherë, në fëmijërinë time, ia varnin paraqitjes së jashtme, rrinin të parruar, në një kohë kur moda e meshkujve të parruar, përgjithësisht e mjekroshëve, ende nuk ishte shfaqur, dhe mezi prisnin të kalonin

ditët, të mbërrinte e shtuna, dhe t'ia mbathnin për t'u kthyer në Tiranë.

Më kryesorja, që e dallonte tim atë nga vendalinjtë katundarë apo të ardhurit kryeqytetas: ai ishte një lexues i zellshëm librash të çdo lloji, artistikë e politikë, çka nuk kaloi pa lënë gjurmë tek unë. Megjithatë, mendoja se im atë, ashtu si unë, duhej ta vuante kompleksin e shtatë lëkurëve përderisa vishej me kostum e kravatë, përpiquej të fliste pastër, me gjuhën e librave, dhe ca rregulla na i impononte edhe neve, pjesëtarëve të tjerë të familjes; nënës, dy motrave të mia dhe mua, më të voglit. Ky kompleks, mendoj, ka përcaktuar qëndrimet e tim ati ndaj meje, që unë të rritesha ndryshe nga të tjerët: kam qenë i përkëdheluri i familjes.

Por më parë ki durim të dëgjosh dy fjalë për fshatin. Ai gjendet në një zonë që aktualisht, në bazë të së ashtuquajturës ndarje e re territoriale, me ç'kam dëgjuar i bashkëngjitet kryeqytetit, për rrjedhojë banorët mund të quhen kryeqytetas dhe ajo shprehja e shtatë lëkurëve zhvlerësohet. Madje, në shenjë kompensimi ndaj humorit përçmues të qytetarëve, këta të fundit cilësoheshin në anët tona me nofkën po aq përçmuese "me nder qytetar". Edhe unë në sytë e tyre mund të jem

një “me nder qytetar”, sido që ende nuk kam ndërruar asnjë lëkurë.

Arsyet, ku nuk dua të ndalem, më shtyjnë të mos e zbuloj emrin e fshatit. Mund ta marrësh me mend, unë nuk e kam të vështirë të sajoi një emër të rëndomtë, nga ata që i has pothuaj në të gjitha krahinat e Shqipërisë, në Jug e në Veri, fjala vjen Qafë, Qerret, Dardhë ose Mollas, Gur i Bardhë, Golem ose Gur i Zi, e kështu me radhë. Në vend të kësaj, nën ndikimin e leximeve, parapëlqej ta shënoj me një shkronjë. Më del se më e përdorura në raste të tilla është shkronja N... Nuk bën ndonjë gabim të madh nëse ti fshatin N. e identifikon me ndonjërin nga fshatrat që përmenda më sipër, të cilësdo krahinë, a me ndonjë fshat tjetër çfarëdo, i njohur apo i panjohur prej teje. Duke bërë këtë marrëveshje, shpresoj të mos kem kokëçarje me ata ose me ato që te fshati N. do të gjejnë fshatin e tyre, rrjedhimisht, të vërejnë mospërputhje të fakteve.

Sa më poshtë, i kam me të dëgjuar, nuk marr përsipër vërtetësinë apo pavërtetësinë e tyre. Marr përsipër vetëm një të vërtetë të pranuar nga të gjithë ata që puna ua ka sjellë të jetojnë në këto vise: është një hapësirë me bukuri natyrore të papërsëritshme. Disave,

malet përreth, u kujtojnë Alpet. Edhe im atë, Alpet duhet të ketë pasur parasysh, përderisa më ka quajtur Alpin, por nuk e kam fjalën këtu. Një hapësirë me bukuri të papërsëritshme natyrore, edhe pse të kujton bukuritë e Alpeve, mund të jetë njëherazi vend internimi, siç ishte zona ku ndodhet fshati im: dikur atje sillnin të internuar. Unë i mbaj mend, banonin në ca baraka rrëzë malit, në njëfarë largësie nga lagjja më e skajshme e fshatit. Duke i kujtuar ata, më vjen ndër mend një thënie, sipas së cilës fshati ynë ka qenë kurdoherë i privilegjuar. Po ta besoj këtë, më duhet të pranoj se ka pasur edhe një kategori të internuarish të privilegjuar. Ndërsa unë vetë i bie të kem qenë i privilegjuar, në një fshat të privilegjuar.

Im atë jepte një varg argumentesh në mbështetje të tezës së statusit të privilegjuar të zonës malore, në qendër të së cilës gjendet fshati N. Qysh përpara se unë të vija në këtë botë, më 22 qershor 1985 - në pikëpamje astronomike, në ditën e solsticit të verës, në pikëpamje astrologjike, s'di ç'të them - lidhej me kryeqytetin me një rrugë automobilistike, të mirëmbajtur dimër-verë, dikur pjesërisht e asfaltuar, sot tërësisht. Privilegj jo i vogël ky, po të shtojmë edhe faktin se një linjë

autobusi lëvizte dy herë në javë, të hënën dhe të shtunën, nga kryeqyteti në fshat dhe anasjelltas. Gojët e liga paskëshin përhapur një version dashakeq. Rruga nëpër terrenin malor mirëmbahej, dhe në dimër pastrohej rregullisht nga bora, për një arsye të thjeshtë: në zonën tonë ndodhej një rezervat me pyje dhe shtëpi gjahu, ku kapot e kohës së pushtetit në kryeqytet, vetë ish-kryeministri, i ekzekutuar apo i vetëvrarë, gjithmonë kur unë ende s'kisha ardhur në këtë botë, vinin për gjuetinë e derrit të egër.

Këtë interpretim nuk e kam dëgjuar prej tim ati, s'di nga kush e kam dëgjuar. Im atë më kumtonte vetëm argumente pozitive, në mbështetje të statusit tonë të privilegjuar. Për shembull, prej shumë vitesh, sërish qysh kur unë ende s'kisha ardhur në këtë botë, te ne ekzistonte një shkollë, e cila me kohë u rrit deri në nivelin e shkollës së mesme, ku mblidheshin nxënës nga fshatrat përreth. Dhe një spital i vogël krahinor në qendër. Dhe një fakt i çuditshëm, disa e quajnë si më domethënësin e statusit tonë të privilegjuar: një shtypshkronjë që mbahej sekret, por që dihej nga të gjithë se ku ndodhej. Kjo do të shërbente në rast lufte, kur ato të kryeqytetit do të dilnin jashtë loje!

Shkolla dhe spitali vazhdojnë të jenë atje ku kanë qenë, shtypshkronja jo. Thuhet se makineritë e saj u vodhën për t'u shitur për skrap. Në pyllin dikur rezervat e që mbytet nga bora në stinën e dimrit, derra të egër duhet të ketë me bollëk, por unë nuk e di nëse kapot e sotëm të pushtetit, ashtu si ata të dikurshmit, shkojnë atje për gjah. Po t'u besosh gojëve të liga, këta të sotmit nuk i tërheq fort sporti i vjetër i gjahut të derrave, ushtrojnë ca sporte të tjera, duhet të kesh dëgjuar për to... E qartë, as të plas fare! Megjithëse nuk je fort origjinale, kjo shprehje i takon një zotërie deputet në një nga seancat e Kuvendit dhe për gllatë një kanal televiziv ia përsërit kohë më kohë me zë e me figurë. Ah, nuk të plas fare as për Kuvendin!

Dakord... Meqë ra fjala te deputeti, për ta mbyllur këtë parantezë privilegjesh, një hollësi e fundit. Fshati N. ka qenë historikisht i përfaqësuar në Kuvendin e Shqipërisë edhe në epokën e gjuetisë së derrave të egër, edhe sot, në erën e re të sporteve moderne. Më shkoqur, krahina jonë ka pasur gjithmonë një deputet në Kuvend. Ky, nëse jo banor i fshatit, si rregull ka qenë me origjinë prej këndej.

Sot, deputeti i krahinës, mik i vjetër fëmijërie i tim ati, banon në Tiranë, e quajnë Kudret



Luga. Po ta shohësh, vështirë të besosh se ai njeri i rëndomtë në pamje të parë, përveçse deputet është edhe bos i një kompanie të fuqishme. Por hëpërhë, ta lëmë edhe zotin Luga atje ku është, në sallën e Kuvendit, në zyrën e tij, apo ku ta dish se ku.

Eja me mua tani, në këtë ditë të ngrohtë e të kthjellët maji të të çoj te prindërit. Jam i sigurt, do t'u bëhej qejfi, megjithëse tepër e vështirë t'u shpjegoj kush je. Ata s'do të merrnin vesh asgjë, po t'u them se ti je ajo pas së cilës kam rendur gjithë jetën pa mundur ta gjej. Do të më vështronin të habitur, të hutuar, po aq të habitur e të hutuar do të vështronin njëri-tjetrin, por kjo s'do t'i pengojë të na ftojnë të zëmë vend në verandën e shtëpisë, ku po rrinë për të vrarë kohën. Në sytë e tyre do të jesh vajza e parë që unë po u çoj në shtëpi, kjo ka qenë dhe mbetet dëshira e tyre e përhershme, pas motrave të më shihnin edhe mua të martuar, mundësisht të trashëguar sa më shpejt.

E shoh, propozimi im s'të pëlqen, idetë me martesë dhe trashëgimtarë ta shpifin. Mbetem një katundar i pandreqshëm, nuk e kam në dorë t'i shpëtoj një mënyre të arsytuari prej katundari të pandreqshëm, pra e tërheq ftesën.

Po i lë edhe prindërit aty ku janë, në verandë, me sytë kah sheshi në qendër.

Nga sa thashë, duhet ta kesh kuptuar, shtëpia ime ndodhet në një pozicion prej nga mund vëzhgohet sheshi në qendër të fshatit. Aty rrotull janë të gjitha: godina përdhese e zyrave të administratës, godina dykatëshe e shkollës dymbëdhjetëvjeçare me një oborr nga prapa, më tej, në njëfarë largësie, godina dykatëshe e spitalit krahinor. Këto, sigurisht, nuk janë më në gjendjen e dikurshme, kush më shumë e kush më pak, janë meremetuar me kalimin e viteve. Në anën e kundërt bie në sy një klub, i frekuentuar nga mënngjesi deri në mbrëmje vetëm nga meshkujt e fshatit, një dyqan berberi si dhe godina më e re krahasuar me ekzistueset, një ushqimore ku përveç sendeve të këtij lloji tregtohen edhe veshmbathje.

Përmend, së fundi, një ndërtesë disi të veçantë. Ajo ndodhet nja dhjetë minuta larg me këmbë nga sheshi i qendrës, është me tulla silikat, me dy hyrje, njihet me emrin “pallati i kuadrove”, në anë të rrugës automobilistike, rreth njëqind e pesëdhjetë metra më këndej. Dikur, këtu strehoheshin familje të ardhura nga kryeqyteti, kryesisht mjekë, ekonomistë, më rrallë arsimitarë. E quajta të veçantë

godinën jo thjesht sepse atje strehoheshin të ardhurit. Ajo lidhet me ty, me njohjen tonë. Ti ke banuar për shumë vite në atë pallat.

Dale, mos u ngut të nxjerrësh përfundime të gabuara, aq më pak t'i quash përçartje kontradiktore pohimet e mia. Asnjë përçartje, asnjë kontradiktë në këtë mes.

Edhe sot e kësaj dite e kam të pamundur të mos mendoj se ti je atje, në dhomën tënde, në katin përdhes. Përshtypja, se ti vazhdon të jesh atje, është aq e fortë sa nuk e kam në dorë të mos i urdhëroj këmbët për të mos shkuar përballë asaj ngrehine dhe me t'u gjendur atje, të mos vështroj një copë herë dritaren e asaj që dikur ishte dhoma jote. Më ndodh kështu sidomos netëve, gjithandej janë ndezur dritat, edhe në pallatin ku banoje ti. Më kot pres që dritarja jote të hapet, prej andej të zbresësh ti dhe në vend që të shkosh prapa pallatit, te mullarët, si shihja ëndrra me sy hapur dikur, të vish drejt meje. Ti nuk vjen, prej vitesh ndodhesh larg. Me një lukth në fyt nxitoj të kthehem drejt shtëpisë.

Pashmangshëm më duhet të përshkoj sheshin. Kur prindërit rrinë në verandë, më shohin. Nëse ti do të pranoje, që në këtë ditë të ngrohtë e të kthjellët maji, të shkonim bashkë atje, nëna do të të mbulonte me të puthura.

Prindërit s'ka sesi të të kenë harruar. Mirëpo, ideja për të vajtur tek ata ty nuk të pëlqen, ndërsa thëniet e mia të duken përçartje.

S'kam ç'bëj! Për të zhdukur ngurrimet e tua, duhet të jem më i qartë, të mos mbytem në këto shpjegime si miza në një gotë me ujë. Të kthehem në zanafillë, kur m'u shfaqe për herë të parë dhe unë u bëra hija jote. Për mua ke qenë një ëndërr, një mjegull. Ti më je shfaqur me fytyra të ndryshme, me emra të ndryshëm, unë as vetë nuk e di se kur filloi e ku do të mbarojë kjo histori me ty.

**A**i nuk i bëri dot ballë tundimit për ta hapur celularin. Paso i një heshtje derisa nga ana tjetër i mbërriti zëri i Emës.

- Të lutem eja sa më shpejt, - i tha ajo, - ndryshe do të luaj mendsh!

Zëri i saj vinte i mbytur. Ai e mori me mend, diçka e rëndë duhej t'i kishte ndodhur, aq e rëndë sa pas gjashtë muajve moskomunikim po i drejtohej atij në mes të natës, po i lutej të shkonte tek ajo. Përvoja e këshilloi të mos e besonte. Në të kaluarën sa herë mbetej keq, ajo e kërkonte shpëtimin tek ai dhe ai e linte veten të gënjehej për t'u zhgënjyer më pas shumë shpejt.

- Dëgjo, - i tha qetësisht, - kemi gjashtë muaj pa folur me njëri-tjetrin. Tani ti më telefonon si pa të keq, më kërkon në mes të natës të marr rrugët e të vij te ti. Harroje, - ia preu, - midis nesh çdo gjë ka marrë fund njëherë e mirë, më lër rehat!

Ai mbylli telefonin. Me mendje të ngritur zuri të vërtitej nëpër sallon, më shumë për t'i dhënë zemër vetes, ky kishte qenë qëndrimi i vetëm i drejtë që duhej të mbante ndaj saj. Gjithnjë për t'i dhënë zemër vetes u ul në kanapënë prej nga, deri në çastin që e kishte ndërprerë tjetra, po ndiqte një film në televizor. Dhe me t'u ulur, celulari, të cilin vazhdonte ta mbante në dorë, tringëlliu sërish.

- Alpi, mos u sill kështu pikërisht sonte... kam një hall të madh, kupton? Kam një hall shumë të madh...

"Çfarë dreqin kërkon prej meje", deshi t'i shfrynte ai, me një ngasje për t'ia mbyllur telefonin prapë. Duke e përmbajtur inatin, gjithsesi nuk ngurroi ta ngacmonte në plagë, aq sa mund të ngacmohej ajo.

- Ndihmën kërkoja dikujt tjetër, - i tha, - jo mua, ti e di mirë se kujt duhet t'ia kërkosh ndihmën!

- O Zot, - u ankua vajza, - ku të ka mbetur mendja... Ndërsa unë jam gati të vras veten.

- Mos na mallëngje, - ia ktheu ai, - s'je nga ato që vrasin veten. Më thuaj, ç'do prej meje?

Pasoi një heshtje e nderë. Dhe zëri i saj mezi i dëgjueshëm:

- S'ta them dot në telefon...

Ai u thye.

- Mirë, sa të vishem po nisem drejt e te ti. Do të mbërrij shpejt, besoj, në këtë orë s'ka trafik.

- Jo tek unë, - sqaroi vajza, - s'jam në shtëpi, jam diku tjetër...

- Pse, - e pyeti ai, - ku je?

Tjetra ngurroi.

- Jam tek Orestin, - pohoi më në fund. - Mos u vono!

- Tek Orestin? - u habit ai. - Po ç'do ti tek Orestin në këtë orë? - shtoi gjithë naivitet.

- Eja sa më shpejt, - këmbënguli ajo dhe i mbylli telefonin.

Ai ngriu.

- Jo, - tha me vete, - e pamundur... e pamundur...

Prej ca kohësh ai nuk shihej as me Orestin. Ata shiheshin vetëm kur ky i fundit e ftonte për ndonjë kafe. Meqë po bëhej më se një muaj që tjetri nuk e merrte në telefon, do të thoshte se gjendja e tij shpirtërore s'duhej të ishte fort e mirë, thënë ndryshe nuk ia kishte

ngenë askujt. E kotë të orvatej për t'u lidhur me të, ta pyeste si ndihej, nëse kishte ndonjë nevojë apo dëshirë, fjala vjen të shkonin për të drekuar diku, në mos po, thjesht për një shëtitje nga bregu i detit: ai e mbante celularin të mbyllur. Dhe, nisur nga nderimi që ushqente për atë njeri, nuk ia kishte dhënë vetes asnjëherë të drejtën ta shqetësonte, domethënë ta merrte në telefon.

- Ajo ka fjetur me Orestin, - mërmëriti i errur, - është e pacipë, krejt e pacipë...

I poshtëruar, e mblodhi, nuk do të shkonte atje, ajo t'i zgjidhte si të donte e me kë të donte ndërlikimet e veta. Pastaj, si u end nëpër dhomë, ndërroi mendje. Meqë në mes ishte Oresti, ai nuk mund të mos shkonte, qoftë thjesht për të mësuar se çfarë fshihej pas këtij teatri të vajzës.

Rreth njëzet minuta më vonë, si e parkoi makinën, një "Volkswagen" e kuqe, në një lagje relativisht të qetë të kryeqytetit, ai u gjend para derës së një apartamenti, në katin e dytë të një pallati trekatësh - falë një shtese tashmë me katër - të stilit të vjetër. Çastin e fundit, kur ngriti dorën për t'i mëshuar sustës së ziles elektrike, ngurroi sërish.

"Të kthehem mbrapsht, - tha me vete, - s'kam punë këtu, në rolin e një karagjozi që e tërheqin për hunde!"



Ndërkaq, dera e apartamentit u hap befas dhe në kuadrat u shfaq Ema. Ata ia ngulën sytë njëri-tjetrit. Ai me një vështrim pyetës që, i shprehur me fjalë, do të formulohej:

- Hajt, më thuaj, çfarë teatri po më luan?

Ajo, me fytyrë të prishur, e zbehtë, pa përreth, nëse në sheshpushimin e katit, bashkë me ish-të dashurin ndodhej ndonjë person tjetër i rastit apo se mos ndonjëra nga dyert e apartamenteve fqinje ishte e hapur. Në sheshpushimin e katit nuk ndodhej askush tjetër përveç të sapoardhurit, ndërsa dyert e apartamenteve fqinje ishin të mbyllura.

- Alpi, - u ankua ajo kur ai u fut brenda, - ka ndodhur diçka e tmerrshme, mos më torturo edhe ti më keq!

- Ç'ka ndodhur, - këmbënguli ai, - më thuaj, ku është Orestin?

- Në dhomën e gjumit, - ia ktheu ajo.

- Ç'hyj unë në këtë mes, - i kërcyen nervat atij nga kjo përgjigje, - je rrahur me Orestin?

- Pse sillesh kaq i poshtër, - e ngriti zërin ajo, - do të kërkoja ndihmën tënde në këtë orë ngaqë jam rrahur me Orestin? O Zot, ç'm'u desh që të thirra ty! Orestin ka vdekur, kupton apo jo? Ka vdekur...

Vajza u shemb në divanin e hollit, mbuloi fytyrën me duar dhe e mbyti dënësia. Ai mbeti

në këmbë i tronditur, pa dashur t'u besonte fjalëve të saj. Në një rrethanë të ndryshme, për shembull, nëse do të ishin vetëm për vetëm dhe Oresti diku aty rrotull, qoftë edhe në dhomën e gjumit, duke fjetur normalisht, ai nuk do t'ia kursente ca të shara. Oresti gjendej vërtet në dhomën e gjumit, por jo i gjallë, sipas saj ai paskej vdekur. Në këto kushte s'do të kishte kurrfarë kuptimi të vriste mendjen se ç'emër duhet t'i vinte Emës.

- Si ndodhi, - e pyeti duke u përmbajtur vështirësisht, - çfarë ndodhi midis jush?

Dhe, si heshti pak, zuri vend në kanape.

- Sa kohë ke që shkoje me të gjorin, - shtoi, - flit, mjaft u qurravite!

Vajza protestoi:

- S'të thirra të më kërkosh llogari, - iu gërmush me zë të ulët, - të thirra të më ndihmosh. Ti duhet të më ndihmosh, më detyrohesh...

- Unë s'të detyrohem për asgjë, - ia ktheu ai.  
- Por nuk është as koha, as vendi ta zgjidhim këtë. Ç'do prej meje?

- Së pari, të më besosh se nuk kam faj...  
Mos më kërkoi hollësira, do të ishte e poshtër, e padrejtë... Ai mbeti sipër meje pasi u përpoq për më se gjysmë ore të mbërrinte në orgazëm. Dhe kur mbërriti... O Zot, nuk kuptova asgjë,

qëndrova nën trupin e tij derisa më zuri paniku, ai nuk jepte asnjë shenjë jete. Zakonisht, ai merrte viagra dhe çdo gjë shkonte në rregull, dua të them pa probleme. Sonte duhej të kishte marrë një dozë të madhe...

- Mjaft, - e ndërpreu ai i neveritur, duke brofur në këmbë. Qëndroi në mes të sallorit, symbyllur, me shpinë të kthyer nga vajza, derisa kërkoi prej saj t'i printe për në dhomën e gjumit. Ajo i priu për atje. Më tej ndaloi në prag të derës, pa guxuar të shkonte pas tij te koka e krevatit. Oresti, mbuluar me çarçaf deri te shpatullat, dukej sikur po flinte përmbys.

- Hap dritaren, - tha ai, më shumë sikur po fliste me veten, - këtu të zihet fryma.

Vajza hapi dritaren.

- Ç'kërkon nga unë, - tha ai gjithnjë sikur po fliste me veten, - më thirre që të shoh se si je kujdesur ta mbulosh me çarçaf, që ai të mos ftohet zbuluar?

- Ti s'mund të hakmerresh kështu ndaj meje, - klithi ajo, - më thuaj ç'të bëj, unë s'di ç'të bëj...

- E thjeshtë, bëj diçka që duhej ta kishe bërë pa qenë nevoja të më merrje mua në telefon. Të lajmërosh kë të duash, ambulancën e urgjencave ose policinë. T'u thuash se ka vdekur një njeri, ai gjendet i shtrirë në krevat,

dhe ata të mbërrijnë për të kryer punët që u takojnë, në adresën që do t'u japësh ti, pasi t'u kesh dhënë edhe emrin tënd... Deshe një këshillë dhe unë ta dhashë, s'kam ç'bëj më këtu, prania ime është e tepërt...

- Ti s'mund të ikësh, - i tha ajo, - s'mund të më lësh vetëm. Po të ikësh do të vras veten, do të hidhem nga dritarja.

Në vend që t'i jepte një shuplakë, siç pati ngasjen, ai i shfryu:

- Po ta përsëris, ti nuk i përket kategorisë së atyre që mund të vrasin veten... Hidhu, pra, ç'pret! Nuk priset bota po të hidhesh, tekefundit, ashtu si macet, në këmbë do të biesh.

Vajza, te dera e dhomës, u përfshi sërish nga një dënesë. Atëherë ai ndërroi mendje. Jo nga shantazhi i saj. Tashmë që ndodhej aty duhej të qëndronte deri në fund.

Mjekët mbërritën rreth pesëmbëdhjetë minuta pas telefonatës së saj. Ata po rrinin në sallon, ai i ulur në një karrige, ajo në anën e kundërt, në divan, të dy të heshtur, pas një acarimi të fundit nervash, kur ajo kishte ngulur këmbë që ambulancës së urgjencave t'i telefononte ai, ndërsa ai e kishte hedhur poshtë kategorikisht këtë kërkesë, duke i

vënë në dukje se tashmë po rrinte aty vetëm në nderim të të vdekurit.

Derën ua hapi ajo. Njëri pas tjetrit në sallon u futën një tip shtatlartë rreth të pesëdhjetave, me syze, i pasuar nga dy më të rinj në moshë e më shtatvegjël, të tre me bluza të bardha dhe çanta në dorë.

- Ku është? - pyeti vajzën mjeku me syze.

- Atje, - iu përgjigj ajo me një fije zëri, duke treguar me dorë dhomën e gjumit.

Të sapoardhurit hodhën drejt tij një vështrim, si të donin të dinin se kush ishte ai person, që e priti mbërritjen e tyre pa denjuar as të lëvizte nga vendi. Ema përpara, ata të tre pas saj, vajtën te dhoma e Orestit, dikush prej tyre mbylli derën dhe ai mbeti në sallon, i mpirë.

Ekipi nuk qëndroi gjatë i mbyllur në dhomë, s'kishte arsye të qëndronte gjatë dhe kur dolën prej andej ai nuk u habit që mbaruan punë aq shpejt. Mjeku me syze vajti në cep të sallonit, nxori telefonin celular, kërkoi një numër dhe u desh njëfarë kohe që dikush t'i përgjigjej nga ana tjetër.

- Jam mjeku i rojës i ambulancës së urgjencave, - foli ai me zë të ulët, - ju lutem më dëgjoni me vëmendje. Unë dhe kolegët e mi sapo kemi konstatuar vdekjen e një personi

rreth të shtatëdhjetave. Problemi është se rrethanat e kësaj vdekjeje janë të paqarta. Ne u lajmëruam në telefon nga një vajzë, të cilën në fillim kujtuam se ishte e bija apo ndonjë mbesë, por del se ajo nuk ka lidhje familjare me të vdekurin... Dyshimet tona i shton një fakt tjetër. I pranishëm në apartamentin e të vdekurit është edhe një individ. Mësuam, se as ai nuk ka ndonjë lidhje familjare me të vdekurin, si duket ky jetonte vetëm. Në këto kushte, përveç konstatimit të vdekjes, ne s'mund të kryejmë asnjë veprim, prandaj e gjykuam të nevojshme t'ju vinim në dijeni, tash e tutje gjithçka është në kompetencën tuaj... Sigurisht, keni të drejtë... ne s'do të largohemi prej këndeje pa ardhur ju...

Kështu ndodhi, mjekët qëndruan aty derisa mbërriti policia. Ai s'mund të thoshte se sa kohë u desh deri në mbërritjen e policisë; dhjetë, pesëmbëdhjetë, më shumë apo më pak minuta. Nga biseda e mjekut në telefon kishte kapur, aty-këtu, fjalë të shkëputura, diçka jo të qartë rreth personit të tij dhe fundin e ligjëratës, domethënë kur folësi i anës tjetër duket kërkoi adresën e banesës dhe mjeku e formuloi me zë relativisht të lartë.

Policëve, ashtu si mjekëve, derën ua hapi vajza. Sallonit të vogël, ku ata po rrinin në

heshtje, iu shtuan tri uniforma blu, dy meshkuj e një femër. I mpirë në karrige ai përfytyroi një skenë. Nga çasti në çast, Oresti do të shfaqej në sallon, me trupin e madh, veshur ceremonial, me kostum e kravatë, do t'u hidhte një vështrim të habitur dhe do t'u thoshte:

- More, ç'është gjithë kjo rrëmujë këtu, në këtë orë të natës, unë s'kam ftuar njeri. Lajmi i përhapur nga kjo zonjusha, - do të shtonte duke treguar Emën me gisht, - është i rremë, unë jam gjallë, s'ka ndodhur asgjë, prandaj largohuni sa nuk është vonë, përndryshe zhurma do të zgjojë fqinjët dhe ec e dëgjo llafet e tyre, ngordhi edhe ky pushti plak, do të thonë. Ndërsa unë, siç e shihni, jam shëndoshë e mirë si molla. Ikni, të qëndrojë vetëm Alpi, atij i detyrohem për një shpjegim...

I vdekuri nuk u shfaq në derën e dhomës. Edhe po të donte s'do të mund të shfaqej, policët ndaluan atje hyrje-daljet e personave të tjerë, përveç mjekut shtatlartë me syze. Pastaj, gjithnjë i mpirë, ai zuri të kryente automatikisht veprimet që i kërkuan të kryente. Në fillim njëri nga policët i tha të lëvizte, të ngrihej nga karrigia dhe të shkonte me të. Ai iu bind, nuk kundërshtoi as kur njeriu i rendit e kapi për krahu dhe ashtu përshkuan shkallët nga kati

i dytë, deri poshtë. Me këtë rast, ai vuri re se, siç kishte parashikuar Oresti, godina qe trazuar nga një lloj rrëmuje, shumica e dyerve të apartamenteve qenë hapur dhe fqinjët po e përcillnin tërë kureshtje kalimin e tij të kapur për krahu nga polici. Ky e shoqëroi te njëri nga dy furgonët e rendit, të parkuar në trotuarin e rrugës buzë pallatit. Logjika e mpirë gjithsesi ia kërkoi që pas tij, e shoqëruar ndoshta nga policja femër, në furgon të mbërrinte Ema.

Puna nuk priti, furgoni u derdh ngadalë nëpër rrugën pothuaj të boshatisur në atë orë të natës dhe në përputhje me një rregull matematikor, sipas të cilit kur ndodhesh i mbërthyer midis dy policësh do të përfundosh pashmangshëm në një komisariat policie, edhe për të tashmë nuk mbetej vendmbërritje tjetër, përveç një komisariati.

“Po ç’punë kam unë atje? - tha me vete i përhumur.”



#### 4.

**S**hpresoj të mos më drejtosh pyetje provokative, ndër të cilat më provokuesja, ndonëse më e natyrshmja, do të ishte se kur, ku dhe me ç'emër më je shfaqur për herë të parë. Po t'i përgjigjem pa doreza kësaj pyetjeje mund të lëndohesh, të më kundërvihesh duke më kujtuar metaforën e shtatë lëkurëve. Arsyeja: gjithçka lidhet me një ves të hershëm, qysh se dikush më zbuloi teknikën universale të masturbimit. As unë, as mentori im në fushën e plotësimit vetjak të dëshirës seksuale, nuk e kishim dëgjuar ende fjalën masturbim. Përdornim thjesht shprehjen e njohur popullore "t'i biesh me dorë". Prandaj

pyetjes sate të natyrshme do t'i përgjigjesha disi paturpësisht: ti më je shfaqur për herë të parë në epokën e masturbimeve të mia. Dhe të quanin Viola.

Mos u lodh kot të këmbëngulësh për të më mbushur mendjen se ti nuk quhesh Viola. Do të vijë një ditë, shpresoj, e ne, më në fund, do të shihemi, do të jemi përballë njëri-tjetrit, çfarëdo emri që të kesh. Tani, të lutem, dëgjo historinë time me variantin Viola të metamorfozave të tua, nëse më lejohet ta quaj edhe këtë një histori. Sa për variantet përpara Violës nuk ia vlen t'i kujtoj, madje s'jam i sigurt nëse kanë ekzistuar vërtet apo i përkasin një mjegullnaje ëndrrash fëmijërore të fshira.

Po e nis me një lodër ku qorrollepsem sa herë kujtoj Violën. Truri im rreket të gjejë shprehjen e kundërt simetrike të metaforës qytetare të shtatë lëkurëve. Dhe them me vete: si do të formulohej ajo nëse fshatarët, për kompensim, në vend të cilësimit “me nder qytetar”, do të krijonin një aforizëm lidhur me numrin e lëkurëve që do t'i duhej të ndërronte një qytetar për t'u bërë fshatar? Në përputhje me këtë, sa lëkurë do të duhej të ndërronte mikeshë ime e ardhshme për t'u bërë fshatare?

Dikur kjo ka qenë një enigmë për mua, një mal i pakapërcyeshëm për të mbërritur te Viola. Sepse ajo vinte nga Tirana, ishte kryeqytetase. Babai i saj, mjek, punonte në spitalin krahinor, po aty kryente detyrën e sanitaresh edhe nëna ime. Nëna e saj, mësuese, jepte mësim në klasat e ulëta të shkollës dymbëdhjetëvjeçare, ku jepte mësim edhe im atë.

Për të qenë i saktë, Violën e mbaj mend qysh se mbaj mend vetveten. Që ajo nuk ishte fshatare si unë, e kam mësuar më vonë, bashkë me hollësira të tjera. Në fillim, kur ende nuk i dija këto hollësira, ajo ishte fshatare si të gjitha vajzat e fshatit, me një ndryshim: mbante një emër të veçantë; asnjë vajzë e fshatit nuk quhej Viola. Shoku im masturbues, i cili e kryente këtë punë duke përfytyruar Violën, më thoshte se eksitohej më shumë nga emri, sesa nga format e trupit të saj. Mua nuk më mbetej hatri nga këto deklarata, asnjë arsye që të më mbetej hatri. Por, me kohë, s'kisha më dëshirë t'i dëgjoja hollësitat e imagjinuara të mentorit tim me Violën. Kjo ndodhi pak a shumë kur në sytë e mi ajo pushoi së qenë fshatare dhe emri i saj i veçantë më sillte ndër mend metaforën asgjësuese të shtatë lëkurëve. Një

llogari e thjeshtë më çon në përfundimin se u ndërgjegjësova mirëfilli për këtë fakt andej nga viti i parë i gjimnazit, edhe pse kisha qenë kurdoherë në të njëjtën klasë me Violën.

Në vitin e parë të gjimnazit, unë dija shumë gjëra rreth saj. I ati, doktori, rridhte nga një familje e pasur. Një herë im atë, kur më mori me vete në Tiranë bashkë me nënën dhe dy motrat, i tregoi nënës një pallat trekatësh në qendër të qytetit, dikur pronë e gjyshit të doktorit. Prindërit e mi, veçanërisht nëna, që punonte me të në spital, flisnin me nderim për doktorin, ndërsa për bashkëshorten e tij, domethënë mamin e Violës - kështu i drejtohej ajo së ëmës, me fjalën mami - nuk para flisnin, duke më lënë të kuptoja se nuk ushqenin edhe për të të njëjtin nderim.

Ndërkaq, unë e kisha të qartë përse prindërit e mi nuk flisnin me të njëjtin nderim si për doktorin, edhe për bashkëshorten e tij. Kjo ishte një grua e bukur. Sipas disave fatkeqësia e doktorit nuk paskej qenë dhe aq prejardhja nga një familje tregtarësh të pasur dhe një numër kushërinjsh të afërm të tij, të vendosur në Amerikë. Fatkeqësia e doktorit qenkej e shoqja, çfarë nuk thuhej për atë grua.

Jam i prirë të mos besoj asgjë. Jam i prirë të besoj se gjithçka duhet të ketë qenë një

legjendë e sajuar nga mëtues të zhgënjyer të hireve të saj. Midis prindërve nuk u hap kurrë ndonjë bisedë rreth kësaj teme në praninë time, por ata duhej ta dinin motivin që e kishte detyruar doktorin ta braktiste kryeqytetin dhe të vendosej në fshatin N., kur e shoqja sapo kishte lindur fëmijën e parë dhe të fundit, Violën.

Më vjen keq që jam i detyruar të ta zbuloj edhe ty legjendën për nënën e bukur të Violës. Në vitin e fundit të fakultetit, doktori, student i shkëlqyer, njihet me një vajzë, e cila shumë shpejt mbetet shtatzënë. Përpara se të lidhej me studentin ajo na paskej kaluar një aventurë, një natë orgji, me pije dhe seks, në shoqërinë e tre meshkujve njëherazi. Përmes një të afërmi të familjes, ky fakt u bie në vesh prindërve të doktorit, këta i bëjnë presion të birit të mbledhë mendjen, vajza është një e përdalë që kërkon t'i mbetet në dorë pasi ka mbetur shtatzënë me të tjerë, ata s'do të pranojnë kurrë, që ai të martohet me të, siç ka ndër mend. Frymë e harxhuar kot!

Kjo është, si të thuash, legjenda e dikurshme, e kohës kur unë ende s'kisha ardhur apo sapo kisha ardhur në këtë botë. Edhe sot e kësaj dite, kujtimi i gruas së bukur dhe i vajzës së saj po aq të bukur,

është ende i gjallë në fshat dhe debati, që ndez me raste bisedat e të ngeshmëve në klubin tonë ekskluzivisht mashkullor, vazhdon të mbetet ai i vjetri: me cilin e ka pasur fëmijën bashkëshortja e doktorit? Nëse jo me këtë të fundit, siç priren të besojnë shumica, me spermën e cilit nga tre meshkujt e tjerë pjesëmarrës në orgji duhet të jetë ngjizur ajo?

Sipas më të informuarve rreth zhvillimeve bashkëkohore të shkencës, sot kjo enigmë mund të zgjidhej lehtë duke ia nënshtruar një testi ADN-të përkatëse të të interesuarve. Edhe unë e kam menduar ndonjëherë këtë, enigma do të zbardhej dhe bashkëfshatarët e mi të ngeshëm, ndoshta, do të gjenin paqen e nevojshme për të mos trazuar më as kujtimin e atyre njerëzve, as shpirtin e vet. Por, meqë kjo nuk mund të ndodhte, isha i detyruar të dëgjoja ç'thoshin ata, madje truri im është vënë në lëvizje më se një herë për zgjidhjen e enigmës duke u nisur pikërisht nga pikëpyetjet dhe arsyetimet e ekspertëve të fshatit N.

“Vërtet, - thosha me vete, - kujt i ngjan Viola?” Vështirë të dilje në përfundimin se ajo kishte ndonjë ngjashmëri fizike me të atin. Ky qe një burrë më afër kategorisë shtatlartë, me fytyrë të rregullt, dua të them me tipare të

rregullta, flokë të zinj, me thinja tek-tuk, sy të zinj, i sjellshëm, në spital e jashtë spitalit, më i sjellshëm se ç'duhej. Sipas nënës sime, njeriun e sjellshëm e nëpërkëmbin, i hipin në qafë, ia nxijnë jetën edhe të tijtë, dhe unë nuk e kuptoja se çfarë mbante parasysh ajo me këto fjalë. Më i kursyer në këtë pikëpamje tregohej im atë. Ky, veç të tjerash, vlerësonte lart, për të mos thënë imitonte, rregullsinë e doktorit në të veshur, ndonëse doktori qe një tip sportiv dhe vishej me kostum e kravatë vetëm në raste të veçanta.

Ngado që ta shihje, Viola nuk ngjante me të atin. Ajo ishte bionde, si e ëma, me sy të kaltër, gjithashtu si e ëma. Në vitin e parë të gjimnazit, gjoksi i saj tërhiqte vështrimet e meshkujve, dhe ndryshe nga shumica e vajzave të fshatit, të cilat e fshihnin nga turpi fryrjen e gjinjve duke e kërrusur trupin përpara, ajo bënte të kundërtën, e mbante trupin drejt dhe përdorte sutiena, që ia vinin në dukje më shumë.

Legjendës së vjetër të orgjisë, kohë më kohë, i mbishtresoheshin legjenda të reja, tradhti ciklike bashkëshortore të nënës së Violës me individë të ndryshëm, aventura të rastit, ose lidhje më të gjata, gjithmonë me meshkuj kryeqytetas, të rinj, të fuqishëm, me parapëlqim

mësuesit e fizkulturës, që zëvendësonin njëri-tjetrin dhe, kur largoheshin nga fshati N., sikur u linin trashëgim pasardhësve edhe gruan e bukur. Një herë u përfol sikur ajo kishte shkuar me drejtorin e gjimnazit, një vendali rreth të pesëdhjetave, por askush nuk e besoi, aq më pak ekspertët e mirinformuar për çdo lëvizje të gruas. Sipas tyre, fjala ishte vetëm për një dëshirë të drejtorit, ky vërtet i vardisej asaj dhe bënte çmos për ta shtënë në dorë, pa sukses, ajo nuk ia varte, s'mund ta ulte pazarin aq poshtë.

Më vjen për të vjellë vetëm duke i kujtuar këto hollësi, të kërkoj ndjesë edhe ty. Shpjegimi im është i thjeshtë. Çdo mashkull, i denjë për këtë cilësim, e pamundur të mos binte në kurthin e hireve të asaj gruaje. Deri edhe nxënësit më të prapë, që prishnin orët e mësimit, në orët e saj hipnotizoheshin, rrinin urtë, i nënshtroheshin me adhurim, si një perëndeshe. Shpesh mendoj se, ashtu si të tjerët, edhe unë isha një viktimë e hipnotizuar e magjisë që çlironte ajo. U çlirova nga kjo magji në vitin e parë të gjimnazit, kur m'u shfaqte ti, në dritën e diellit, me emrin Viola.

Ky pohim është thjesht një mënyrë të shprehuri, siç të kam vënë në dukje, Violën unë e mbaja mend qysh se mbaja mend



vetveten. Mirëpo, atë vit, kur hyra në gjimnaz, s'mund të them se çfarë ndodhi me mua, m'u duk sikur Violën po e shihja për herë të parë. Duhet të ketë ndikuar mungesa a saj në fshat gjatë pushimeve të verës. Duhet të ketë ndikuar edhe fakti që gjatë asaj vere, ajo qe shndërruar nga një bionde lëkurëbardhë, në njëfarë mulateje të zeshkët, aq shumë kishte qëndruar në diell.

Kur e pashë së largu në oborrin e shkollës, në fillim nuk e njoha. Ajo vuri buzën në gaz, zuri të vinte drejt meje dhe unë mezi i rashë në të se kush ishte vajza që më buzëqeshte. Flokët e dendur, të verdhë, zakonisht të lëshuar mbi supe, i kishte mbledhur gërshet, një gërshet i rëndë, i kapur në fund me një fjongo të madhe në ngjyrë të kaltër. Mbante një fustan veror të shkurtër. Unë isha mësuar ta shihja me xhinse dhe rrallë kështu, me një fustan aq të shkurtër e shumë sipër gjunjëve.

- Dreq, - m'u dha t'i flisja më në fund, - paske ndryshuar fare, mezi të njoha...

- Kam qenë në plazh, me prindërit, - u përgjigj ajo, - në fillim në Durrës, por s'qëndruam gjatë atje, vetëm pak ditë, deti ishte pis dhe mamit nuk i pëlqeu. Pastaj babi e rregulloi të shkonim në Sarandë. Po ti ç'ke bërë? - më pyeti.

- Hiç, - iu përgjigja, - kam qenë nja dy herë në Tiranë, me tim atë.

Pas një ngurrimi të shkurtër, shtova:

- Këtë vjeshtë do të shpallim fejesën e motrës së madhe.

- Kaq shpejt ka vendosur të fejojhet ajo?

- Pse shpejt, - ia ktheva unë, - Merita i ka mbushur prej disa muajsh nëntëmbëdhjetë vjeçët...

- Duket më e vogël, - tha ajo, - po me kë do të fejojhet, kush nga djemtë e këtij fshati do të ketë fatin ta marrë për grua?

- Nuk besoj ta mbash mend atë djalin, ka ikur nga Shqipëria para shumë vitesh, ndodhet në Itali, tani është me dokumente të rregullta, kupton?

- Kuptoj, - m'u përgjigj ajo, - më bëhet qejfi për Meritën.

Më shkrepri t'i zbuloja edhe një të fshehtë. Vajtja gjatë asaj vere në Tiranë dy herë radhazi nuk lidhej vetëm me fejesën e motrës së madhe. Ajo lidhej me projektin e jetës së tim ati, ëndrrën e tij më të hershme, për të cilën shkriu gjithçka: blerjen e një apartamenti në kryeqytet. Kur të vinte koha unë do të vendosesha atje sapo të nisja studimet, me parapëlqim Fakultetin e Drejtësisë.

Nuk ia zura me gojë Violës asgjë nga këto.

Ja ngaqë porosia e tim ati ishte të mos i bisedoja me njeri, ja ngaqë mua vetë këto ide më dukeshin të largëta, të porealizueshme, im atë kush e di për ç'arsye më ushqente me përralla, ja ngaqë përpara Violës, së shndërruar gjatë pushimeve të verës, goja m'u lidh.

Atë ditë, pas mësimit, u ktheva në shtëpi i pështjelluar, fytyra e Violës nuk më shqitej. Këtu është vendi të shtoj edhe nja dy fjalë të tjera për shtëpinë.

Si ta kam shpjeguar, ajo është relativisht e madhe, dykatëshe, me verandë dhe kopsht, e rrethuar nga të katër anët me mur. Largësia nga dera e jashtme prej hekuri deri te hyrja e shtëpisë është e shtruar me çimento. Kjo rrugëz e ndan kopshtin më dysh. Në njërin anë ngrihet madhështor një dru arre, sipas tim ati i mbjellë atje nga katragjyshi i tij. Po në këtë anë, gjendet ajo që unë e quaja “kasollja e Larës”. Lara ka qenë emri i lopës sonë, kur unë isha fare i vogël, ky emër i mbeti edhe më pas, kur asaj ia zuri vendin një lopë tjetër, kështu quhet edhe sot. Në të vërtetë, ajo nuk është kasolle. Është një ngrëhinë me mure prej druri, me çati të stilit alpin, me dy kate. Në atë përdhesin, një lloj hauri, strehohej

lopa, në të dytin, ndarë nga përdhesi me një tavan të drunjtë, vendosej rezerva ushqimore për dimër.

Fëmijëria ime e hershme i përket epokës, kur një familje në fshatin tonë mund të mbante vetëm një lopë, asnjë kokë dele, këto ishin të tufëzuara, kundërvajtësit gjobiteshin, mund të përfundonin edhe më keq. Kam dëgjuar historinë e çuditshme të një banori të fshatit, i cili, përveç një lope të deklaruar, mbante fshehurazi në shtëpi, në njërën nga dhomat ngjitur me ato ku flinin njerëzit, edhe një lopë të dytë, e kjo paskej vazhduar me vite, derisa pjesëtarja ilegale e familjes qenkej zbuluar dhe të gjithë ata mjeranë paskëshin qarë me lot kur ishin ndarë përdhunshëm prej saj.

Ne kemi pasur gjithmonë vetëm një lopë. Duke qenë i privilegjuar në një fshat të privilegjuar, im atë nuk më nxirrte të kryeja angarinë e loparit. Sa herë i vinte radha familjes sonë për të kullotur tufën e lagjes, këtë detyrë, gjatë pushimeve, kur shkolla mbyllej, e kryenin motrat e mia. Në rastet, kur asnjëra nga motrat s'mund të dilte me lopë për shkak të shkollës, im atë e zgjidhte ndryshe, me ndonjë bedel, kundrejt një pagese me para në

dorë ose në natyrë, por kurrë nuk më nxori mua.

Ti mund ta komentosh si të duash këtë fakt, domethënë që mua s'm'u desh asnjëherë të dilja me lopë. Përgjithësisht, s'm'u desh asnjëherë të kryeja angaritë e mbijetesës në fshat, që binin mbi kurrizin e nënës dhe motrave, pa përjashtuar tim atë. Nuk dua të zgjatem, thjesht më mundon një ndjenjë prej fajtori kur i kujtoj. Këtë e them pa hipokrizi. Atëherë, gjithçka që bëhej për mua e quaja të natyrshme përderisa kështu vendoste im atë. Ai kërkonte prej meje vetëm një gjë, të dilja i shkëlqyer në mësim, dhe unë bëja çmos të mos e zhgënjeja; të dilja i shkëlqyer në mësim. Kjo sjellje e tij ndaj meje, e ka një shpjegim. Për ta sqaruar, po i drejtohem një fotografie të hershme, të cilën im atë e mbante në një album, ku besoj të gjendet edhe tani.

Ajo është e përmasave të vogla, bardhezi. Prapa saj, dikush ka vendosur shënimin: Korrik, 1955 - kohë kur duket është marrë fotografia e rrallë, me sfond shtëpinë. Shkrimi i shënimit nuk është i tim ati, unë e njoh shkrimin e tij. Ka të ngjarë të jetë i fotografit, i ndonjë personi tjetër të afërm, mbase i gjyshit tim, hollësi pa ndonjë domethënie kjo.

Domethënës janë personat që pozojnë në të, shtatë vetë, të vendosur në dy radhë.

Nga radha e parë, ulur mbi një stol, të hedhin vështrime të ngrira një burrë, nja dyzet e pesë vjeç, me mustaqe, dhe një grua pak më e re në moshë, përkatësisht gjyshi dhe gjyshja ime. Ata janë veshur me rroba verore, gjyshi me një këmishë të bardhë, gjyshja me një fustan të gjatë, të errët, me flokët të mbështjellë në shami. Në mes të tyre qëndron një fëmijë nja dy-tre vjeç, me kokë të qethur tullë. Ky është im atë.

Në radhën e dytë, përbri njëra-tjetrës, pozojnë katër vajza, në këmbë, me fustane verore nga e njëjta cohë e të të njëjtit model, tri prej tyre gati të ngrysura në fytyrë dhe vetëm njëra ka sajuar diçka si buzëqeshje. Janë motrat e tim ati, të gjitha më të mëdha se ai.

Mbase mund ta kesh vënë re: im atë, ashtu si unë, ka qenë djalë i vetëm, me ndryshimin se ai vinte i fundit pas katër motrave, ndërsa unë i fundit pas dy motrave. Ky ka qenë edhe shansi i tim ati, krahasuar me gjyshin, nuk iu desh të këmbëngulte aq gjatë për të mbërritur deri tek unë.

Ka edhe ngjashmëri të tjera midis nesh. Dikur im atë ka qenë i vetmi nga fëmijët, të cilit iu dha mundësia të ndiqte studimet në

universitet, në degën histori-geografi. Unë kam qenë i vetmi që m'u dha mundësia të vazhdoja studimet në kohën e duhur. E them këtë, sepse vetëm njëra nga motrat, atë e quajnë Yllka, ia doli të kryente studimet, disi me vonesë, falë vullnetit të saj dhe përkrahjes së bashkëshortit. Këto hollësi e të tjera të ngjashme të statusit tim të privilegjuar, më kanë çuar në një përfundim: im atë përmes meje kishte vendosur të realizonte një ëndërr që s'kishte mundur ta realizonte vetë. Gjithçka më jep të kuptoj se ai e vuante metaforën e shtatë lëkurëve dhe bëri çmos që unë të mos prekesha prej saj.

Së fundi, një informacion plotësues që transmetohet përmes fotografisë. Në sfond duket shtëpia në gjendjen e para më shumë se gjysmë shekulli. Fotografi më të hershme, kur ajo ishte vetëm me një kat, nuk ekzistojnë. Në pozicionin prej nga është marrë, druri i arrës nuk duket. Nuk duket as rrugëza përmes kopshtit, as ndonjë fragment i murit të sotëm rrethues, këta dy të fundit sepse nuk ekzistonin. Në atë kohë, shtëpia ka qenë e pasuvatuar, me mure prej tullash të kuqe, por pa verandë, e mbuluar nga një çati tjegullash, që nuk është më. Vendin e saj e ka zënë një tarracë dhe tarraca mbulohet me pjergull. Në

të djathtë, në katin e dytë, shquhet dritarja e vogël e një dhome, ku dikur kanë fjetur motrat e tim ati. Me një dritare të re më të madhe, kjo është dhoma ime.

Historia me variantin Viola të metamorfozave të tua nis mirëfilli atë ditë, kur pas mësimit u ktheva në shtëpi i pështjelluar dhe vajta u mbylla në dhomën time. Përderisa tërë kohën përpara syve më rrinte Viola, e shndërruar gjatë verës, me nxirjen prej mulateje, gërshetin e trashë të kapur me fjongo dhe fustanin e shkurtër, do të thoshte se, pështjellimi im e kishte emrin Viola. S'më kishte vajtur nëpër mend, se do të mbërrinte një çast e unë do ta shihja Violën e fëmijërisë ndryshe, siç e kisha parë atë ditë në shkollë, e ajo më që dukur e huaj.

“Po ajo është e huaj! - thashë me vete, sikur po bëja një zbulim. - Si është e mundur, të mos e kem vënë re se ajo është e huaj, - e vazhdova arsyetimin, - që unë dhe ajo jemi të ndryshëm?”

I hutuar, zura vend në tryezën time të punës, pranë dritares. Tutje, në kopsht, s'dukej këmbë njeriu. Im atë dhe nëna duhej të ishin ende në punë, motra e madhe, e mbyllur në dhomën e vajzave, përballë dhomës sime, në



pritje të shpalljes së shpejti të fejesës, motra tjetër kush e di se ku, ndoshta bashkë me të madhen për t'i bërë shoqëri, duke ëndërruar edhe ajo t'i dilte fati e të fejohej sa më shpejt. Dhe truri më punoi një rreng.

“Si ia bëjnë motrat e mia, - thashë me vete, - për të kënaqur dëshirat e tyre? A kanë edhe ato ndonjë shoqe që t'u mësojë ndonjë marifet, të ngjashëm me marifetin e mentorit tim masturbues?”

Për t'u ikur këtyre mendimeve të poshtra vendosa të merresha me diçka, të hapja ndonjë libër, çfarëdo që të ishte. Për fat, mbi tryezë gjendej një libër, një roman i lënë përgjysmë, i një shkrimtari të huaj; atëherë lexoja vetëm të huajt. Orvatje e kotë, e pamundur të përqendrohesh. Dhe, tek rrekesh të lexoja, Viola m'u shfaq midis rreshtave të librit. Doli prej andej në përmasat e një kukulle, ashtu siç e kisha parë në mëngjes, dhe qëndroi në mes të tryezës me një buzëqeshje enigmatike.

“Mbi të gjitha, - më tha, - tani mos u masturbo si ai miku yt idiot, që e ka bërë zakon të shfryhet duke më përfytyruar të zhveshur dhe bën seks me mua, e këto ti i di sepse ai t'i tregon me mburrje, e ti nuk ndihesh t'i thuash atij debili, se ai mund të bëjë seks me mua vetëm po të shohë majën e veshit

pa pasqyrë. Në vend që të masturbohesh, siç kam një përshtypje të fortë, sonte, rreth orës tetë, eja para pallatit tim. Me t'u errur, unë do të dal nga shtëpia dhe shkojmë tek ajo ara me mullarë prapa pallatit, është një vend ideal ku mund të rrimë pa na shqetësuar njeri.”

I mora seriozisht fjalët e Violës. Asgjë nuk më shtynte të mos i merrja seriozisht. Pa mbushur ende pesëmbëdhjetë vjeç, mund të bëja çdo marrëzi për të, mjafton të më jepte një shenjë. Ajo ma kishte dhënë një shenjë.

Orët deri në mbrëmje i kalova pa bërë asgjë. Në ato çaste, kur shihja ëndrra me sy hapur, përfytyroja sikur me të mbërritur para pallatit të saj, ajo do të dilte nga shtëpia e veshur njëlloj si në mëngjes, prej andej do të shkonim në arën me mullarë prapa pallatit dhe atje në fillim do ta puthja duke e shtrënguar fort, do ta shtrija pranë ndonjë mullari e më tej nuk e di se çfarë do të bëja, deri atë ditë unë as kisha puthur, as kisha bërë seks me ndonjë vajzë, dua të them me të vërtetë, jo duke u masturbuar. Tek shtrydhja trutë për ta zgjidhur këtë enigmë, në veshë ndjeva të më pëshpëriste një zë.

“Qenke teveqel, - më tha zëri, - mos u bëj merak, të mëson Viola, ta kam thënë, ajo duhet të jetë ustalleshë!”